



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr.155

4 dhjetor

2012

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr. 7819 datë 19.11.2012	Për lejjimin e lënies së shtetësisë shqiptare 8389
Vendim i KM nr. 778, datë 7.11.2012	Për miratimin standardeve të përgjithshme, minimale, të personelit NJTIK për strukturimin organizativ të njësive të teknologjisë së informacionit e të komunikimit..... 8390
Vendim i KM nr. 780, datë 14.11.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr. 848, datë 21.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 400 kV Tiranë 2 - Elbasan 2, qarku i Elbasanit” 8400
Vendim i KM nr. 781, datë 14.11.2012	Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujqor (detar, lumor dhe liqenor) 8402
Vendim i KM nr. 782, datë 14.11.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të fëmijës Mandrin Cuni, aksidentuar nga shpërthimi i një granate 8408
Vendim i KM nr. 783, datë 14.11.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të fëmijës Jurgens Cuni, aksidentuar nga shpërthimi i një granate 8408
Vendim i KM nr. 784, datë 14.11.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të fëmijës Besnik Cuni, aksidentuar nga shpërthimi i një granate 8409

Vendim i KM nr. 785, datë 14.11.2012	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga sistemimi i shtratit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralel saj (segmenti nga Materniteti i Ri në gjatësinë 400 m në drejtim të kundërt të rrjedhës së Lanës) në Bashkinë e Tiranës	8409
Vendim i KM nr. 786, datë 14.11.2012	Për dhënien në përdorim të përkohshëm nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Brendshme, të objektit nr. 36, me emërtimin “Ish-Kolegji Turk”, dhe të truallit funksional, pjesë e pronës nr. 12, me emërtimin “Komanda e Doktrinave dhe Stërvitjes”, Tiranë, me sipërfaqen e përgjithshme 7594 m ² , për Shkollën e Administratës Publike Shqiptare	8412
	Vendim për shpalljen të vdekur të shtetasit Kostantin Duka...	8421

DEKRET
Nr. 7819, datë 19.11.2012

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Fabian Palë Rupa
2. Ylli Fadil Halili
3. Majlinda Agim Memedi (Shehi)
4. Laura Ruzhdi Pupovci
5. Florentina Ruzhdi Pupovci
6. Alban Sokol Gjillani
7. Roland Xhelal Skura
8. Sigurim Tahir Tafa
9. Ergys Idai Xhafaj
10. Lulzim Dostan Koldashi
11. Denada Haxhi Seitz (Blaka)
12. Eva Xhelal Hasani (Puka)
13. Gino Arben Hasani
14. Matias Arben Hasani
15. Violeta Lahim Halilaj (Hoxha)
16. Migena Genc Musaraj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani



VENDIM
Nr. 778, datë 7.11.2012

**PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË PËRGJITHSHME, MINIMALE, TË
PERSONELIT NJTIK PËR STRUKTURIMIN ORGANIZATIV TË NJËSIVE TË
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT E TË KOMUNIKIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e standardeve të përgjithshme, minimale, të personelit NJTIK për strukturimin organizativ të njësive të teknologjisë së informacionit e të komunikimit, sipas anekseve 1 dhe 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Dispozitat e këtij vendimi zbatohen për institucionet e administratës publike, në nivel qendror, ku përfshihen aparatet e Kryeministrit, të ministrive, degët e ministrive, institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit dhe ministrive të linjës dhe degët e tyre, si dhe administrata e prefektit.

Rekomandohen drejtuesit e institucioneve qendrore të pavarura, përfshi ato të sistemit gjyqësor e të prokurorisë, e institucioneve të arsimit të lartë dhe të fondeve speciale, të zbatojnë të njëjtat standarde gjatë hartimit të strukturave të teknologjisë së informacionit e të komunikimit për administratat e institucioneve të tyre.

3. Ngarkohen ministri që mbulon departamentin e administratës publike, në bashkërendim me Ministrin e Financave dhe Ministrin për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, të përgatitin, për propozim, strukturën, masën e pagës dhe të shtesave mbi pagë të nëpunësve të njësive të teknologjisë së informacionit e të komunikimit.

4. Ngarkohen ministri që mbulon departamentin e administratës publike dhe Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit të nxjerrin udhëzimin e përbashkët për kriteret e veçanta të nevojshme për hartimin e strukturave të njësive të teknologjisë së informacionit e të komunikimit dhe për mënyrën e bashkëpunimit e të bashkërendimit të punës në këto njësi.

5. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Financave dhe Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1

Nr.	Funkisonet	Struktura e klasifikimit të punëve në shërbimin civil
1.	Drejtues i Njësisë të Teknologjisë së Informacionit (CIO)	Klasa e I Klasa e II
2.	Administrator Sistemi	Klasa e III
3.	Konsulent për TIK	
4.	Arkitekt Sistemi	
5.	Drejtues i Projekteve	
6.	Auditues/Përgjegjës Cilesie	
7.	Përgjegjës për proceset TIK	
8.	Përgjegjës për Sigurinë e TIK	
9.	Përgjegjës për TIK	
10.	Përgjegjës për Shërbimet dhe Helpdesk	
11.	Analist i Proceseve	
12.	Analist Sistemi	
13.	Specialist i Bazës së të Dhënave	
14.	Specialist për Sigurinë e TIK	
15.	Specialist Rrjeti	
16.	Specialist për Shërbimet TIK dhe Helpdesk	
17.	Specialist Testimi	Klasa e IV
18.	Zhvillues Aplikimesh	
19.	Specialist Teknik	
20.	Trainues TIK	
21.	Specialist për Helpdesk	



ANEKSI 2

Në tabelat e mëposhtme jepen karakteristikat e përgjithëshme të 20 funksioneve TIK të përmendura më sipër.

Titulli/Profili	(1) Drejtor i njësisë të teknologjisë së informacionit (CIO)	
Përshkrimi	Zhvillon dhe mirëmban Sisteme Informacioni për të plotësuar nevojat e institucionit.	
Misioni	Harton dhe implementon strategji dhe politika të TIK-ut. Përcakton resurset e nevojshme për implementimin e strategjive TIK. Parashikon zhvillimet e reja në fushën e TIK-ut dhe nevojat e institucionit. Kontribuon në hartimin e planeve strategjike. Udhëheq ose merr pjesë në projekte të ndryshme.	
Rezultatet e pritura	Përgjegjes	Kontribues
	• Strategjia TIK dhe implementimi • Departamenti TIK dhe buxheti • Portofolin e projektit • SLA • Strategji për Sigurinë e Informacionit	• Politikat e menaxhimit të rriskut

Titulli/Profili	(2) Administrator Sistemi	
Përshkrimi	Administron komponentet e Sistemeve TIK për ofruar shërbimin e kërkuar.	
Misioni	Instalon, konfigurin dhe përmirësojnë sistemet TIK. Sigurojnë funksionalitet ditë-pas-dite që të plotësojë vazhdimësinë e shërbimeve, rimekëmbjen, sigurinë dhe performancën.	
Rezultatet e pritura	Përgjegjes	Kontribues
	• Zgjidhje Operacionale	• Zgjidhjen e Incidenteve

Titulli/Profili	(3) Konsulent i TIK-ut	
Përshkrimi	Ndihmon në të kuptuarin e rolit të teknologjive të reja të TIK-ut dhe në krijimin e vlerës së shtuar për biznesin.	
Misioni	Sigurojnë ndjekjen e zhvillimeve të reja teknologjike për të informuar palët e interesuara rreth teknologjive emergjente. Parashikon dhe realizon projekte TIK duke rritur ndërgjegjësimin rreth teknologjive të reja. Identifikon dhe shpjegon krijimin e vlerës së institucionit nga përdorimi i teknologjive të reja. Kontribuon në përcaktimin e projekteve të bazuara në teknologjitë e reja.	
Rezultatet e pritura	Përgjegjës	Kontribues
	• Propozimin e integritetit të	• Marrëdhëniet e Institucionit

	teknologjive të reja • Bazën e njohurive ose informacionit (në fushën e tij)	• Kërkesat e Institucionit • Planifikimin e Projekteve
--	---	---

Titulli/Profili	(4) Arkitekt Sistemi	
Përshkrimi	Projekton dhe miremban Arkitekturën e Sistemit	
Misioni	Në mënyrë që të kemi një Arkitekturë Sistemi të balancuar dhe solide: balancimi i mundësive teknologjike kundrejt kërkesave të institucionit (procesit), garanton paisjen e një vizioni strategjik të organizatës, proceseve, informacionit dhe mjeteve të TIK-ut dhe koherencën midis Sistemit të Informacionit dhe nevojave të institucionit dhe evoluimin e tyre.	
Rezultatet e pritura	Përgjegjës	Kontribues
	• Arkitekturën e Sistemit • Lidhjen me arkitekturat e fushave të tjera (arkitekturën e aplikimit, arkitekturën e infrastrukturës, arkitekturën e të dhënave, etj.)	• Planin e Institucionit • Propozimin për integrimin e teknologjive të reja • Bazën e njohurive ose informacionit • Përcaktimin e Proceseve të Institucionit

Titulli/Profili	(5) Drejtues Projekti	
Përshkrimi	Drejton projektin me objektivin për arritjen e performances optimale në përputhje me specifikimet e tij.	
Misioni	Percakton, implementon dhe administron një projekt nga konceptimi e deri në dorëzimin përfundimtar për të arritur rezultate optimale, në përputhje me kërkesat në lidhje me cilësinë, qëllimin, performancën, kostot, afatin kohor, qëndrueshmërinë dhe sigurinë.	
Rezultatet e pritura	Përgjegjës	Kontribues
	• Plan Projekti • Zgjidhja e miratuar • Dokumentim i zgjidhjes • Plani i produktit	• Plani i cilësisë • Zgjidhja e integruar

Titulli/Profili	(6) Auditues / Përgjegjës Cilësie	
Përshkrimi	Garanton ofrimin e sistemeve të informacionit në përputhje me politikat e institucionit (cilësia, rrisku, Kontratat në Nivel Shërbimi (SLA)).	



Misioni	Krijon dhe zbaton praktikën e sigurimit të cilësisë TIK në përputhje me praktikën e përgjithshme të institucionit. Siguron që kontrollet janë zbatuar në mënyrë korrekte për të garantuar ruajtjen e aseteve, integritetin e të dhënave dhe që operacionet të jenë fokusuar në qëllimin dhe objektivat e institucionit. Garanton zbatimin e planeve të veprimeve korrigjuese.	
Rezultatet e pritura	Përgjegjes	Kontribues
	• Raporte auditimi • Indikatorët e performancës së cilësisë	• Sigurimin e cilësisë • Politikën e cilësisë TIK • Politikën e menaxhimit të riskut • Politikën e sigurisë së Informacionit

Titulli/Profili	(7) Përgjegjës për proceset TIK	
Përshkrimi	Propozon, planifikon dhe menaxhon zhvillimet funksionale dhe teknike të Sistemeve të Informacionit të institucionit.	
Misioni	Menaxhon dhe implementon projekte të reja dhe përditeson aplikimet ekzistuese, duke përfshirë mirëmbajtjen në përputhje me nevojat, shpenzimet dhe planet e miratuara me përdoruesit e brendshëm. Garanton cilësinë e shërbimeve dhe kënaqjen e përdoruesve të brendshëm. Propozon zgjidhje të reja në përputhje me zhvillimet e reja teknologjike dhe funksionale.	
Rezultatet e pritura	Përgjegjes	Kontribues
	• Kontraktimin • Portofolin e projektit • Specifikimin e zgjidhjeve • SLA	• Plan Biznesi • Përcaktimin e procesve TIK • Planin e produkteve

Titulli/Profili	(8) Përgjegjës i Sigurisë së TIK-ut	
Përshkrimi	Menaxhon politikën e Sigurisë së Sistemeve të Informacionit.	
Misioni	Harton politikën e Sigurisë së Sistemeve të Informacionit. Menaxhon zbatimin e tyre për të gjithë Sistemin e Informacionit. Siguron ofrimin e disponueshmërisë së informacionit. Njihet si ekspert i sigurisë së TIK-ut nga palët e interesuara brenda dhe jashtë institucionit.	
Rezultatet e pritura	Përgjegjës	Kontribues
	• Politikën e sigurisë së informacionit	• Politikën e Menaxhimit të Riskut • Propozimin e integritetit të

	• Bazat e Njohurive dhe Informacionit • Strategjinë e sigurisë së informacionit	teknologjive të reja • Strategjitë e Sistemeve të Informacionit
--	--	--

Titulli/Profili	(9) Përgjegjës i TIK-ut	
Përshkrimi	Menaxhon operacionet, njerëzit dhe burime të tjera të aktivitetëve të TIK-ut.	
Misioni	Projekton, implementon dhe mirëmban një pjesë të paracaktuar të TIK-ut. Siguron që aktivitetet të realizohen në përputhje me rregullat, proceset dhe standardet e TIK-ut. Parashtron ndryshimet e nevojshme në përputhje me strategjinë dhe kontrollin e kostove të kompanisë. Vlerëson dhe rekomandon investimet në teknologjitë e reja. Siguron efektivitetin e menaxhimit të TIK-ut dhe të rriskut të lidhura me të.	
Rezultatet e pritura	Përgjegjës	Kontribues
	• Planifikimin e Buxhetit • Planin e Zhvillimit të Burimeve Njereëzore • Programet e Trajnimit	• Siguron përmbushjen e detyrimeve ekologjike

Titulli/Profili	(10) Përgjegjës për Shërbimet dhe Helpdesk	
Përshkrimi	Planifikon, implementon dhe kontrollon ofrimin e zgjidhjeve.	
Misioni	Percakton përshkrimin e Linjave të Shërbimeve dhe Produkteve, SLA-ne, kontratat e Marreveshjeve në Nivel Operacional (OLA) dhe Indikatorët Kyc të Performances (KPIs) në fushat e ndryshme të Institucionit në bashkepunim me Audituesin/Përgjeggjës të Cilësisë të Institucionit. Monitoron, raporton dhe menaxhon përmbushjen e SLA-se. Në rastet e mos përmbushjes së detyrimeve, ndërmer veprime për zvogelimin e tyre, në bashkepunim me Audituesin/Përgjeggjës të Cilësisë. Në bashkepunim me strukturën përgjegjëse për financën e institucionit, kontribuon në alokimin e kostove të mirëmbajtjes.	
Rezultatet e pritura	Përgjegjës	Kontribues
	• Zgjidhje operacionale • SLA • Zgjidhjen e incidentëve	• Parashikimin e Prodhimit • Indikatorët e Cilësisë • Propozime teknike



Titulli/Profili	(11) Analist i Proceseve	
Përshkrimi	Propozon dhe nxit zgjidhje TIK për përmirësimin e performancës së institucionit.	
Misioni	Identifikon fushat ku janë të nevojshme ndryshimet e sistemit të informacionit dhe pastaj monitoron impaktin e tyre në kuadër të menaxhimit të ndryshimeve. Propozon dhe nxit zgjidhjet TIK të cilat kontribuojnë në performancën e institucionit. Kontribuon në kërkesat funksionale të përgjithshme të nevojshme të institucionit në fushën e zgjidhjeve TIK. Garanton cilësinë e parashtrimit të nevojave të institucionit në fushën e zgjidhjeve TIK.	
Rezultatet e pritura	Përgjegjës	Kontribues
	• Përcaktimin e kërkesave të institucionit • Propozimin e zgjidhjeve të Institucionit (Business case) • Marrëdhëniet ndërinstitucionale	• Planin e Institucionit • Strategjinë TIK • Modele TIK

Titulli/Profili	(12) Analist Sistemi	
Përshkrimi	Planifikon zgjidhje, kërkon rreth problemeve, rekomandon softuere dhe sisteme dhe koordinon zhvillimet për të përmbushur kërkesat.	
Misioni	Siguron projektimin, zhvillimin dhe testimin si dhe kontribuon në Implementimin e aplikacioneve të reja të TIK-ut dhe/ose përmirësimin e tyre.	
Rezultatet e pritura	Përgjegjës	Kontribues
	• Vlerësimin e Nevojave Softuerike • Zgjidhje të Integruara • Specifikimin e zgjidhjeve • Propozime Teknike	• Komponentet Harduere • Komponentet Softuere • Përcaktimin e Proceseve TIK • Modele të TIK-ut

Titulli/Profili	(13) Specialist i Bazës së të dhënave	
Përshkrimi	Projekton, implementon, monitoron dhe mirëmban bazat e të dhënave.	
Misioni	Ofron projektimin, implementimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e bazës së të dhënave të organizatës për të mbështetur zgjidhjet e sistemit të informacionit në bazë të nevojave për informacion të institucionit. Siguron projektimin dhe zhvillimin e strategjive për bazat e të dhënave, monitorimin dhe rritjen e performancës dhe kapacitetit të bazës së të dhënave si dhe planifikimin për kërkesën për zgjerim në të ardhmen. Planifikon, koordinon dhe implementon masa të sigurisë për të mbrojtur bazat e të dhënave.	

Rezultatet e pritura	Përgjegjës	Kontribues
	• Modelet e të dhënave • Specifikimet e zgjidhjeve • Zgjidhje operationale	• Modelet e TIK-ut • Procedurat e testimit • Zgjidhjen e Incidenteve

Titulli/Profili	(14) Specialist i Sigurisë të TIK	
Përshkrimi	Garanton implementimin e politikës së sigurisë.	
Misioni	Përmbush detyrat dhe propozon përditësimet e nevojshme. Siguron rolin mbështetës në konsulencë si dhe të informimit në lidhje me trajnimet dhe sigurinë. Ndërmerr veprime në mënyrë të drejtpërdrejtë, mbi të gjitha ose për një pjesë të një sistemi rrjeti. Është eksperti i sigurisë në TIK për palët e brendshme të interesuara.	
Rezultatet e pritura	Përgjegjës • Njohuritë ose baza e informacionit • Propozimet mbi integrimin e teknologjive të reja	Kontribues • Politikat e Menaxhimit të Riskut • Plani i Menaxhimit të Riskut • Politikat e sigurisë së informacionit

Titulli/Profili	(15) Specialist Rrjeti	
Përshkrimi	Garanton përpuethshmërinë e fushës së veprimit të rrjetit me nevojat e organizatës për komunikim.	
Misioni	Drejton dhe vë në funksionim një sistem informacioni të lidhur në rrjet, duke zgjidhur problemet dhe defektet që të sigurohen nivele shërbimi të përcaktuara. Monitoron dhe përmireson performancat e rrjetit.	
Rezultatet e pritura	Përgjegjës • Dokumentim i zgjidhjeve të rrjetit • Zgjidhje të rrjetit në funksionim • Specifikime të zgjidhjeve të rrjetit	Kontribues • Incidente të zgjidhura • Garanci për sigurinë

Titulli/Profili	(16) Specialist për Shërbimet dhe Helpdesk	
Përshkrimi	Ofron shërbime TIK dhe/ose suport telefonik dhe me e-mail për klientet që kanë probleme teknike në përdorimin e pajisjeve të TIK ose aplikacioneve softuerike.	



Misioni	Te siguroje mbështetje të përdoruesve si dhe riparim, shërbime të pajisjeve të TIK ose aplikacioneve softuerike. Objektivi kryesor është që përdoruesve t'u krijohet mundësia për të maksimizuar produktivitetin e tyre nëpërmjet përdorimit eficient të pajisjeve të TIK ose aplikacioneve softuerike.	
Rezultatet e pritura	Përgjegjes	Kontribues
	• Suport i nivelit të dytë	• Incident i zgjidhur

Titulli/Profili	(17) Specialist testimi	
Përshkrimi	Projekton dhe performon planet e testimit.	
Misioni	Kontribuon në pasjen e një sistemi të saktë dhe të plotë për të përmbushur kërkesat teknike dhe ato të përdoruesit. Kontribuon në disa fusha të ndryshme të zhvillimit të sistemeve, testimet e sistemit, duke identifikuar anomalitë dhe duke analizuar shkaqet e mundshme.	
Rezultatet e pritura	Përgjegjes	Kontribues
	• Planet e testimit • Procedurat e testimit • Rezultatet e testimit	• Integrimin e zgjidhjeve • Validimin e zgjidhjeve • Dokumentacionin e zgjidhjeve

Titulli/Profili	(18) Specialist Teknik	
Përshkrimi	Miremban dhe riparon hardueret dhe softueret në mjediset e klientit.	
Misioni	Të instalojë, zgjidhë problemet, riparojë dëmet dhe të kryejë mirëmbajtjen e komponenteve harduere dhe/ose softuere. Përgjegjes për realizimin e riparimeve në kohën e duhur dhe në mënyrë efektive për të siguruar performancën optimale të sistemit dhe kënaqësi të lartë për përdoruesit.	
Rezultatet e pritura	Përgjegjes	Kontribues
	• Zgjidhjen e incidenteve	• Dokumentacionin e zgjidhjeve

Titulli/Profili	(19) Zhvillues Aplikimesh	
Përshkrimi	Projekton dhe zhvillon zgjidhjet TIK dhe specifikon produktet e TIK-ut sipas nevojave të institucionit.	
Misioni	Siguron ndërtimin dhe implementimin e aplikimeve TIK. Kontribuon në planifikimin dhe projektimin e nivelit të ulët.	

Rezultatet e pritura	Përgjegjës	Kontribues
	• Komponentët Harduere • Komponentët Softuere • Dokumentacion e zgjidhjeve	• Përshkrimin e Projektimit të Softuerit • Procedurat e testimit • Programin e trajnimit • Zgjidhje operationale

Titulli/Profili	(20) Trajnues i TIK-ut	
Përshkrimi	Edukon dhe trajnon të tjerët për të arritur standardet e paracaktuara të kompetencës teknike/biznesi të TIK-ut.	
Misioni	Ju ofron studenteve njohuritë dhe aftesitë e nevojshme për të siguruar që studentët të jenë në gjendje të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë efektive.	
Rezultatet e pritura	Përgjegjës	Kontribues
	• Kurset e trajnimeve	• Politikat e trajnimeve të TIK-ut • Programet e Trajnimit

Titulli/Profili	(21) Specialist për Helpdesk	
Pershkrimi	Ofrojnë suport të nivelit të parë, telefonik dhe me e-mail për klientet që kanë probleme teknike në përdorimin e pajisjeve të TIK ose aplikacioneve softuerike.	
Misioni	Të sigurojë suport telefonik dhe email të përdoruesve si dhe të lidhet me Specialistin e Shërbimeve TIK dhe Helpdesk për ndihmë, shërbime dhe riparim të pajisjeve të TIK ose aplikacioneve softuerike.	
Rezultatet e pritura	Përgjegjës	Kontribues
	• Suport i nivelit të parë	• Incident i zgjidhur



VENDIM
Nr. 780, datë 14.11.2012

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 848, DATË 21.10.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
LINJËS 400 KV TIRANË 2 - ELBASAN 2, QARKU I ELBASANIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pikat 3 dhe 4 të vendimit nr. 848, datë 21.10.2010 të Këshillit të Ministrave, ndryshohen si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen e përgjithshme 5 832.7 (pesë mijë e tetëqind e tridhjetë e dy pikë shtatë) m², vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 138 274 629.6 (njëqind e tridhjetë e tetë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e njëzet e nëntë pikë gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 138 274 629.6 (njëqind e tridhjetë e tetë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e njëzet e nëntë pikë gjashtë) lekësh, të përballohet nga fondet e OST sh.a.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHPRONËSIM DEFINITIV

Nr.	Objekti	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Nr. i shtyllës	Sasia, shpronësimit definitiv m ²	Sip. e ndërtesës	Çmimi m ² AKKP	Çmimi, shitje ZRPP lekë/m ²	Vlera totale e kompensimit në lekë	Adresa e pronarit	Dokumentacioni
1	Itl 400	Bujar	Emin	Gjata	Magazinë	2124	34/1/5	105-106		76.7		48678	3,733,603	Bradashesh	Me certifikatë pronësie
2	Itl 400	Mustafa Gentian	Musa Mustafa	Sharra Sharra	Magazinë	2124	545/4/1	104-105		120		48678	5,841,360	Bradashesh	Me certifikatë pronësie
3	Itl 400	Ilija	Anastas	Gega	Arë	3371	202/1	102	98		496		48,608	Bradashesh	Me certifikatë pronësie



VENDIM
Nr. 781, datë 14.11.2012

**PËR CILËSINË E DISA LËNDËVE TË DJEGSHME, TË LËNGSHME, PËR PËRDORIM
TERMIK, CIVIL E INDUSTRIAL, SI DHE PËR PËRDORIM NË MJETET E
TRANSPORTIT UJOR (DETAR, LUMOR DHE LIQENOR)^{1*}**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 12 e 16 e të pikave 2 e 3 të shtojcës II të ligjit nr. 9501, datë 3.4.2006 “Për ratifikimin e traktatit të krijimit të Komunitetit të Energjisë”, dhe të pikës 5 të nenit 10 të ligjit nr. 8897, datë 16.5.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për qëllim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm do të nënkuptohet:

a) “Lëndë djegëse e lëngët e rëndë” (*heavy fuel oil*):

- çdo lëndë djegëse e lëngët, e prodhuar nga hidrokarburet, që përfshihen në kodet CN 2710 19 51 deri CN 2710 19 55; CN 2710 19 62 deri CN 2710 19 68; CN 2710 20 31 deri CN 2710 20 39; ose

- çdo lëndë djegëse e lëngët, e prodhuar nga hidrokarburet, përveç gazoilit, siç përcaktohet në shkronjën “b”, e cila, për shkak të kufijve të saj të distilimit, përfshihet në kategorinë e lëndës djegëse të lëngët të rëndë, të destinuar për përdorim si lëndë djegëse dhe prej së cilës më pak se 65 % ndaj volumit (duke përfshirë humbjet) distilohet në 250°C, sipas metodës SSH EN ISO 3405, ekuivalente me metodën ASTM D 86. Në qoftë se distilimi nuk mund të përcaktohet sipas metodës SSH EN ISO 3405, ekuivalente me metodën ASTM D 86, produkti hidrokarbur do të kategorizohet si lëndë djegëse e lëngët e rëndë.

b) “Lëndë djegëse e lëngët e mesme e rëndë” (*gas oil*):

- çdo lëndë djegëse e lëngët, e prodhuar nga hidrokarburet, përjashtuar lëndët djegëse të lëngëta marinë, që përfshihen në kodet CN 2710 19 25, 2710 19 29, CN 2710 19 47; CN 2710 1948; CN 2710 20 17; CN 2710 20 19; ose

- çdo lëndë djegëse e lëngët, e prodhuar nga hidrokarburet, përjashtuar lëndët djegëse të lëngëta marinë, prej së cilës më pak se 65 % ndaj volumit (duke përfshirë humbjet) distilohet në 250°C prej së cilës më pak se 85 % ndaj volumit (duke përfshirë humbjet) distilohet në 350°C sipas metodës SSH EN ISO 3405, ekuivalente me metodën ASTM D 86.

c) “Lëndë djegëse të lëngëta marinë” (*marine fuel*):

- çdo lëndë djegëse e lëngët, e prodhuar nga hidrokarburet, të destinuara për përdorim ose përdorim në bordin e një anijeje, përfshirë edhe ato lëndë djegëse të lëngëta, të përcaktuara në ISO 8217.

ç) “Tregtim i lëndëve djegëse të lëngëta”, importimi, eksportimi dhe blerja e shitja e lëndëve djegëse të lëngëta për përdorim termik civil dhe industrial.

2. Në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke filluar nga data 31 dhjetor 2012, do të lejohet si lëndë djegëse për përdorim termik, civil e industrial, vetëm tregtimi i lëndëve djegëse të lëngëta të mesme, të rënda (*gas oil*), që në nomenklaturën e mallrave, përshkruhet në kodet:

a) CN 2710 19 25 (vajguri);

b) CN 2710 19 29 (lëndë djegëse të lëngëta, fraksione të mesme);

¹ Ky vendim ka përafruar direktivën 1999/32/EC të Këshillit të datës 26 prill 1999 në lidhje me “Një reduktim në përmbajtjen e squfurit të disa lëndëve të djegshme dhe të lëngshme” dhe direktivën amenduese 93/12/EEC (ScF).

c) CN 2710 19 46; CN 2710 20 15 (gazoil me një përmbajtje squfuri më tepër se 0.001% ndaj masës, por jo më tepër se 0.002% ndaj masës);

ç) CN 2710 19 47; CN 2710 20 17 (gazoil me një përmbajtje squfuri më tepër se 0.002% ndaj masës, por jo më tepër se 0.1% ndaj masës); ose

d) CN 2710 19 48; CN 2710 20 19 (gazoil me përmbajtje squfuri më tepër se 0,1% ndaj masës, por jo më tepër se 1%) ndaj masës, që plotëson kërkesat e standardit shqiptar SSH UNI 6579 ose të standardeve të tjera, të barasvlershme me të, siç parashikohet në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lëndët djegëse të lëngëta të mesme të rënda (*gas oil*), të përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të kësaj pike, mund të përdoren për makineritë lëvizëse jorrugore dhe për traktorët e makineritë e tjera bujqësore, me kusht që përmbajtja e squfurit të jetë më e vogël se 0,1%.

3. a) Në territorin e Republikës së Shqipërisë do të lejohet, për përdorim termik civil e industrial, vetëm tregtimi i lëndës djegëse të lëngët të rëndë (*heavy fuel oil*), që në nomenklaturën e mallrave, përshkruhet në kodet CN 2710 19 51 deri CN 2710 19 55; CN 2710 19 62 deri CN 2710 19 68; CN 2710 20 31 deri CN 2710 20 39, që plotëson kërkesat e standardit shqiptar SSH UNI 6579 ose të standardeve të tjera të barasvlershme me të, me përjashtim të kushtit për përmbajtjen e squfurit, siç parashikohet në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Përmbajtja e squfurit, në lëndët djegëse të lëngëta të rënda:

b.1) pas datës 31 dhjetor 2013 nuk duhet të kalojë 3% ndaj masës;

b.2) pas datës 31 dhjetor 2014 nuk duhet të kalojë 1% ndaj masës.

Kërkesat që u referohen paragrafëve b.1 dhe b.2 të shkronjës “b”, nuk zbatohen ndaj subjekteve që i kontrollojnë shkarkimet në ajër:

i) Impiantet e reja me djegie, që përdorin lëndë djegëse të lëngët, të cilat respektojnë normat e shkarkimeve të SO₂ sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet mjedisore”.

ii) Impiantet ekzistuese me djegie, që përdorin lëndë djegëse të lëngët, ku shkarkimet e SO₂ janë më të vogla ose të barabarta me 1700 mg/Nm³, me një përmbajtje vëllimore oksigjeni në gazet e shkarkuara 3%, në kushte të thata.

iii) Impiantet me djegie, që përdorin lëndë djegëse të lëngët, të cilat nuk janë sipas përcaktimeve të nënndarjeve, as “i” dhe as “ii”, por që nuk kalojnë shkarkimet e SO₂ mbi 1700 mg/Nm³, me një përmbajtje vëllimore oksigjeni në gazet e shkarkuara 3%, në kushte të thata.

iv) Impiantet me djegie, që përdorin lëndë djegëse të lëngët në rafineri, ku vlera mesatare mujore e shkarkimeve të SO₂ nuk kalon 1700 mg/Nm³. Kjo nuk zbatohet në rast se impiantet, që përdorin lëndë djegëse në rafineri, përfshihen në përcaktimet e nënndarjeve “i” ose “ii”.

v) Të gjitha impiantet me djegie që rregullohen sipas nënndarjeve “i”-“iv” më sipër të shkronjës “b” të pikës 3, duhet të operojnë në bazë të kushteve të përcaktuara në lejen e integruar mjedisore, të lëshuar nga autoriteti përkatës.

4. Në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke filluar nga data 31 dhjetor 2012, do të lejohet, për qëllim përdorimi në mjete të transportit ujor (detar, lumor ose liqenor), vetëm tregtimi i lëndëve djegëse të lëngëta marinë (*marine fuel*), që plotësojnë kërkesat e standardit shqiptar SSH ISO 8217 ose të standardeve të tjera, të barasvlershme me të, me përjashtim të kushtit për përmbajtjen e squfurit, siç parashikohet në aneksin 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Nëse, si rezultat i një ndryshimi të papritur, në furnizimin e vendit me naftë të papërpunuar, produkte të naftës dhe hidrokarbure të tjera (ndërprerje e tregut), bëhet e vështirë, për të aplikuar kufizime për përmbajtjen maksimale të squfurit referuar në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi, ministria përgjegjëse për hidrokarburet, pas marrjes së miratimit prej Këshillit të Ministrave, të shprehur nëpërmjet vendimit përkatës, për këtë situatë do të informojë Sekretariatën e Komunitetit të Energjisë në Vjenë, për procedim të mëtejshëm.



Trajtimi i këtyre bëhet në bashkërendim me institucionet e Komunitetit të Energjisë, në përputhje dhe respektim të të drejtave dhe detyrimeve, që burojnë nga nenet 47 dhe 67 të traktatit për krijimin e Komunitetit të Energjisë.

6. Institucionet përgjegjëse për kontrollin e standardeve të cilësisë në tregun e naftës dhe të nënprodukteve të saj të marrin të gjitha masat e nevojshme për të ushtruar kontrolle, lidhur me respektimin e përmbajtjes së squfurit në lëndët djegëse të lëngshme për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor), për të qenë në përputhje me përcaktimet në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi.

Marrja e mostrave, kryerja e analizave, si dhe testimi i çdo parametri të lëndëve djegëse të lëngshme, të përmendura në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi, të bëhen sipas metodave të analizave të përcaktuara në standardet përkatëse në fuqi nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardeve.

7. Nëse pas datës 1 tetor 2012 për pikat 2 dhe 4 të këtij vendimi, si dhe respektivisht pas datës 1 janar 2014, për pikën 3.b.1 dhe pas datës 1 janar 2015 për pikën 3.b.2 të këtij vendimi, evidentohen subjekte, që tregtojnë lëndë djegëse të lëngëta, me cilësi, që nuk respektojnë kërkesat e këtij vendimi:

a) për treguesit e tjerë tekniko-cilësorë, që janë brenda vlerave të lejuara sipas standardeve në fuqi, zbatohen sanksionet e parashikuara në nenin 25 të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar;

b) për treguesit e tjerë tekniko-cilësorë, që ndryshojnë dhe nuk janë brenda vlerave të lejuara sipas standardeve në fuqi, lëndët djegëse të lëngëta sekuestrohen, në zbatim të nenit 11 të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Sekuestrimi i lëndëve djegëse të lëngshme dhe përcaktimi i destinacionit të produkteve të sekuestruara bëhen nga Inspektorati Qendror Teknik, në përputhje me procedurat e përcaktuara në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrisë të Financave, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministri i Financave, që brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të përgatitin dhe të miratojnë udhëzimin e përbashkët për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave, për cilësinë e lëndëve djegëse të lëngëta të mesme të rënda (*gas oil*), lëndëve djegëse të lëngëta të rënda (*heavy fuel oil*) dhe lëndëve djegëse të lëngëta marinë (*marine fuel*).

9. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave të nxjerrin udhëzimet përkatëse, në zbatim të përcaktimeve të pikave 7 shkronja “b”, dhe 8 të këtij vendimi.

10. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Aneksi 1

Treguesit e lejuar mjedisor për lëndët djegëse (vajguri-gazoil) për përdorim termik civil dhe industrial

Lloji i lëngës djegëse	Njësia	Vajguri (kerosinë)	Gazoil ≤0,1	Gazoil >0,1
	Njësia	A	B	C
Pika flakërimit	°C	≥28	>55	>52
Masa vëllimore në 15°C	Kg/m ³	770 deri 830	815 - 875	815 - 875
Distilimi				
Në 150°C	%(v/v)	-	≤2 ¹	≤2 ¹
Në 210°C	%(v/v)	<90		
Në 250°C	%(v/v)	≥65	<65	
Në 300°C	%(v/v)			<60
Në 350°C	%(v/v)		≥85	<85
Squfuri	%(m/m)	≤0,2	≤0,1	≤1
Nikel+Vanad	mg/kg	≤15	≤15	≤15
PCB (PoliClorBifenil)	mg/kg	<4	<4	<4
PCT (PoliClorTrifenil)	mg/kg	<10	<10	<10
Ngjyra(2)		po	po	po
Shënimi (1) :nuk është i nevojshëm kur pika e flakërimit është më e madhe ose e barabartë me 65°C Shënimi (2): është i detyrueshëm ngjyrosja,për produktet (A,B,C), sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi				



Aneksi 2

Parametrat e lejuar mjedisor për lëndët djegëse (distilate të rënda nga nafta) për përdorim termik civil dhe industrial

Lloji i lëngës djegëse	Njësia	Lende djegese te lengeta te renda te naftes (heavy fuel oil)	
		Solar	Mazut
	Njësia	D	E
Pika flakërimit	$^{\circ}\text{C}$	>65	>80
Hiri	% (m/m)	$\leq 0,1$	$\leq 0,2$
Squfuri	% (m/m)	≤ 3 (pas dt.31.12. 2013) ≤ 1 (pas dt.31.12. 2014)	≤ 3 (pas dt.31.12. 2013) ≤ 1 (pas dt.31.12. 2014)
Nikel+Vanad	mg/kg	≤ 180	≤ 230
PCB (PoliClorBifenil)	mg/kg	<4	<4
PCT (PoliClorTrifenil)	mg/kg	<10	<10
Fuqia kalorifike	MJ/kg	≥ 40	≥ 40

Aneksi 3

Parametrat e lejuar mjedisor për lëndët djegëse për Marinën (marine fuel)

Treguesit	Njësia e matjes	limitet	Produkti			
			DMX	DMA	DMZ	DMB
Masa vëllimore në 15 °C	kg/m ³	max.	-	890,0	890,0	900,0
Pika e flakërimit	°C	min.	43,0	60,0	60,0	60,0
Indeksi i Cetanit	-	min.	45	40	40	35
Përmbajtja e squfurit	%(m/m)	max.	1,00	1,50	1,50	2,00
Përmbajtja e H ₂ S (hidrogjeni i sulfuruar)	mg/kg	max.	2,00	2,00	2,00	2,00
Mbetje karboni(metoda mikro e 10% në volum mbetje distilimi)	%(m/m)	max.	0,30	0,30	0,30	-



VENDIM
Nr. 782, datë 14.11.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT
TË FËMIJËS MANDRIN CUNI, AKSIDENTUAR NGA SHPËRTHIMI I NJË GRANATE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, zëri “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi 3 302 880 (tre milionë e treqind e dy mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të fëmijës Mandrin Cuni, aksidentuar nga shpërthimi i një granate.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 783, datë 14.11.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT
TË FËMIJËS JURGENS CUNI, AKSIDENTUAR NGA SHPËRTHIMI I NJË GRANATE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, zëri “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi 3 134 880 (tre milionë e njëqind e tridhjetë e katër mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të fëmijës Jurgens Cuni, aksidentuar nga shpërthimi i një granate.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 784, datë 14.11.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT
TË FËMIJËS BESNIK CUNI, AKSIDENTUAR NGA SHPËRTHIMI I NJË GRANATE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, zëri “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi 3 235 680 (tre milionë e dyqind e tridhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të fëmijës Besnik Cuni, aksidentuar nga shpërthimi i një granate.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 785, datë 14.11.2012

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA SISTEMIMI I SHTRATIT TË
LANËS DHE NDËRTIMI I RRUGËVE PARALEL SAJ (SEGMENTI NGA MATERNITETI I
RI NË GJATËSINË 400 M NË DREJTIM TË KUNDËRT TË RRJEDHËS SË LANËS) NË
BASHKINË E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5/1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga sistemimi i shtratit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralel saj (segmenti nga Materniteti i Ri në gjatësinë 400 m në drejtim të kundërt të rrjedhës së Lanës) në Bashkinë e Tiranës.

2. Pasuritë, në sipërfaqen prej 2 598 (dy mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë) m² truall dhe 48 (dyzet e tetë) m² objekt, pronë private, që shpronësohen, si dhe pronarët që shpronësohen, janë sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, e cila është pjesë përbërëse e tij.



3. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve shpronësohen, është 57 826 118 (pesëdhjetë e shtatë milionë e tetëqind e njëzet e gjashtë mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga buxheti i Bashkisë së Tiranës.

4. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Tiranës.

6. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia e Tiranës, për realizimin e këtij projekti.

7. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 2 598 (dy mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë) m² truall dhe 48 (dyzet e tetë) m² objekt, shpronësuar në favor të Bashkisë së Tiranës, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR SISTEMIMIN E SHTRITIT TË LANES DHE NDËRTIMIN E RRUGËVE PARALEL SAJË (SEGMENTI NGA MATERNITETI I RI NË GJATËSINË 400 m NË DREJTIM TË KUNDËRT TË RRJEDHËS SË LANËS), NË BASHKINË E TIRANËS

Nr.	Emrat e Pronareve	Sip. Truall m ²	Çmimi Lekë/ m ²	Sip. Objekti m ²	Çmimi Lekë/ m ²	Vlera trull + objekt lekë	Zonat	Nr. Pasurisë	Dok.i pronësisë
1	Osman Tetova plus bashkëpronarët	24	22 996			551 904	Zona 1/2	2/119	Vërt. Pronësie
2	Gëzim Çome plus katër bashkëpronarë	60	22 996			1 379 760	Zona 1/2	2/157	Vërt. Pronësie
3	Bashkëpronarët Domi	124	22 996			2 851 504	Zona 1/2	2/153	Vërt. Pronësie
4	Familja Tabaku (M. Tabaku)	18	21 593			388 674	Zona 3/2	7/322	Vërt. Pronësie
5	Myzejen Çollhai (Limani) plus dy bashkëpronarë	322	21 593			6 952 946	Zona 3/2	3/233	Vërt. Pronësie
6	Edile Taku plus pesë bashkëpronarë	541	21 593			11 681 813	Zona 3/2	2/140	Vërt. Pronësie
7	Edile Taku plus pesë bashkëpronarë	153	21 593			3 303 729	Zona 3/2	2/139	Vërt. Pronësie
8	Sonada Daja dhe Anxhela Daja	518	215 93			11 185 174	Zona 3/2	3/243	Vërt. Pronësie
9	Memo Malaj			48	29 910	1 435 680	Zona 3/2	3/277N-1	Vërt. Pronësie
10	Memo Malaj, Jetnor Malaj dhe Zyber Allushi,	678	21 593			14 640 054	Zona 3/2	3/244	Vërt. Pronësie
11	Jetnor Malaj	160	21 593			3 454 880	Zona 3/2	3/276	Vërt. Pronësie
12	Agush Karameta		21 593				Zona 3/2	2/25	Ska Informacion
	Shuma në Total	2 598		48		57 826 118			



VENDIM
Nr. 786, datë 14.11.2012

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM NGA MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRISË SË BRENDSHME, TË OBJEKTIT NR. 36, ME EMËRTIMIN “ISH-KOLEGJI
TURK”, DHE TË TRUALLIT FUNKSIONAL, PJESË E PRONËS NR. 12, ME EMËRTIMIN
“KOMANDA E DOKTRINAVE DHE STËRVITJES”, TIRANË, ME SIPËRFAQEN E
PËRGJITHSHME 7594 M², PËR SHKOLLËN E ADMINISTRATËS PUBLIKE SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 8 dhe të neneve 10 e 12 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim të përkohshëm, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Brendshme, të objektit nr. 36, me sipërfaqen ndërtimore 870.87 (tetëqind e shtatëdhjetë pikë tetëdhjetë e shtatë) m², me emërtimin “Ish-Kolegji Turk”, dhe truallin funksional, gjithsej 7594 (shtatë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e katër) m², pjesë e pronës nr. 12, me emërtimin “Komanda e Doktrinae dhe Stërvitjes”, Tiranë, për një periudhë 40-vjeçare, sipas planvendosjes dhe planimetrive, që i bashkëlidhen këtij vendimi, për ta përdorur për Shkollën e Administratës Publike Shqiptare.

2. Ministrisë së Brendshme i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

Në rastin e përfundimit të veprimtarisë dhe aktivitetit të Shkollës së Administratës Publike Shqiptare, para afatit të përcaktuar në këtë vendim, objekti dhe trualli funksional t’i kthehen Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Mbrojtjes dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLAN-VENDOISJA


Pjese e Pronës Nr.12 për dh ënien në përdorim

Ministrisë së Brerëndshme



















VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr.1247 (3871), datë 7.5.2012, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Kostantin Duka, i biri i Jovanit dhe i Lenës, i datëlindjes 24.5.1965.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 3.12.2012
Doli nga shtypi më 4.12.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 36 lekë